# Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria "Albpetrol SH.A", shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin e **Specialist në Drejtorinë e Logjistikës dhe Koordinimit të Shërbimeve** një kandidat profesionist, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

| | |
|---|---|
| **Arsimimi** | • Të jetë i diplomuar në një nga degët e Fakultetit Ekonomik, në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja; |
| **Eksperiencë pune** | • Preferohet të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në profesion;<br>• Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm; |
| **Cilësitë** | • Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.<br>• Kanë avantazh aplikantët që kanë punuar në administratën publike;<br>• Kanë avantazh aplikantët që zotërojnë gjuhën angleze;<br>• Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikim me gojë/shkrim, të jetë i përshtatshëm për të punuar në grup, si dhe i hapur ndaj sfidave të ndryshme që mund të lindin nga procesi i punës;<br>• Nivel i lartë integriteti, besueshmërie dhe orientimi të rezultateve.<br>• Aftësitë kompjuterike janë thelbësore; |